

# Partia Demokratike

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 144 Prot.

Tiranë, më 24 . 04 .2023

## K Ë R K E S Ë

**KËRKUES:** Partia Demokratike e Shqipërisë, me seli në adresën: Blv. Zhan D'Ark, Nr. 11, Tiranë, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, **Z. Flamur Noka**.

**OBJEKTI:** Kërkesë për fillimin e menjëhershëm të hetimit të shkelje ligjore të kryera nga Ndërkomunalja Bushat sh.a. dhe Bashkia Vau Dejës.

**DREJTUAR:** **Z. Bledar ÇUÇI**  
Ministër i Brendshëm

**Z. Ulsi MANJA**  
Ministër i Drejtësisë

**PËR DIJENI:** **Z. Muhamet RRUMBULLAKU**  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

**Z. Florin DEMOLLARI**  
Drejtor i Përgjithshëm i Antikorrupsionit

**TIRANË**

*Zotërinj Ministra,*

Nëpërmjet kësaj kërkesë, dëshiroj t'ju informoj lidhur me një ngjarje shumë të rëndë të ndodhur në Bashkinë Vau Dejës, që përfshin shkelje flagrante ligjore nga administratori Agron Ceka i Ndërkomunales Bushat sh.a., kompania shtetërore që ka në pronësi landfillin e Bushatit, dhe kryetari i Bashkisë Vau Dejës, Mark Babani, me një vlerë totale dëmi 685 milionë lekë.

Konkretisht, në datën 17 qershor 2022, koncesionari privat që administron landfillin e Bushatit, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me një kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për 12 fatura të periudhës Gusht 2017–Gusht 2018, me vlerë detyrimi 500 milionë dhe

kamata ligjore 185 milionë lekë.

Gjyqtari Andri Ymeri, i shkarkuar tashmë nga vettingu, pa verifikuar vërtetësinë e faturave dhe ekzistencën reale të detyrimeve, në shkelje flagrante të ligjit, në datën 13 shtator 2022, vendosi të pranojë kërkesën, duke njohur detyrimin e shoqërisë koncesionare në shumën 685 milionë lekë (**Prova nr. 1 – Vendimi gjyqësor**).

Pas zbardhjes së vendimit, shoqëria koncesionare ka vendosur në ekzekutim vendimin gjyqësor, nëpërmjet zyrës përmbartimore, duke njoftuar shoqërinë Ndërkomunale Bushat sh.a., një shoqëri 100% në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, për detyrimin në shumën 685 milionë lekë. Veprimi i parë që administratori i Ndërkomunalja Bushat sh.a., Agron Ceka, duhet të kishte kryer është verifikimi i ekzistencës së detyrimit që pasqyrohej në vendimin gjyqësor.

Kjo pasi, sic rezulton nga nxjerrjet e llogarisë bankare të Ndërkomunalja Bushat sh.a., të 12 faturat kanë qenë plotësisht të shlyera ndaj shoqërisë koncesionare (**Prova nr. 2 – Nxjerrjet e llogarisë bankare**). Kjo konfirmohet edhe nga administratori i kohës, z. Albert Markolaj. Në këto kushte, veprimi normal që duhet të kishte kryer administratori Ceka është t'i drejtohej gjykatës, duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të urdhërit të ekzekutimit, pasi detyrimi 685 milionë lekë nuk ekzistonte.

Por, në vend të këtij veprimi, në 21 mars 2023, administratori Ceka ka lidhur një marrëveshje me kryetarin e Bashkisë Vau Dejës, Mark Babani, (**Prova nr. 3 – Marrëveshja**), nëpërmjet të cilës ky i fundit merr përsipër që të kalojë 100 milionë lekë për shlyerjen e borxheve ndaj shoqërisë koncesionare. Edhe kryetari i bashkisë ka vepruar në shkelje flagrante të ligjit, pasi neni 54, gërma “dh”, e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, detyron kryetarin e bashkisë që për çdo ndryshim në buxhet të marrë miratimin e Këshillit Bashkiak (**Prova nr. 4 – Buxheti i bashkisë 2023**).

Por, jo vetëm miratimin e këshillit bashkiak nuk e ka marrë, por pa kryer asnjë lloj verifikimi nëpërmjet drejtorisë juridike dhe financës për ekzistencën reale të detyrimit, Mark Babani kalon 100 milionë lekë nga paratë e taksapaguesve të qytetarëve të Vau Dejësit, për një detyrim që nuk ekzistonte ((**Prova nr. 5 – Urdhëri**)).

E gjitha kjo nuk është tjetër, vecse një skemë e paligjshme me qëllim vjedhjen e 685 milionë lekëve të qytetarëve të Vau Dejësit. Kjo skemë përfshin gjyqtarin Andri Ymeri, të larguar nga vetting-u, administratorin e Ndërkomunalja Bushat sh.a., Agron Ceka, dhe kryetarin në ikje të Bashkisë Vau Dejës, Mark Babani. Minimalisht të tre këta shtetas duhet të ishin sot përpara organeve të drejtësisë, për shpërdorim detyre, ndërsa hije të forta dyshimi për veprimtari të pastër korruptive.

Prandaj, në cilësinë e organeve të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji, për hetimin e veprimtarive të paligjshme, me pasoja të rënda ekonomike për qytetarët, kërkojmë nga ana juaj fillimin e

mënjehershëm të hetimit të shkeljeve ligjore të kryera nga administratori i Ndërkomunales Bushat sh.a., shtetasi Agron Ceka dhe kryetari i Bashkisë Vau Dejës, shtetasi Mark Babani.

Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj.

**PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË**  
**Flamur NOKA**

(  
Sekretar i Përgjithshëm





1

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Numri i Ceshtjes : 11233-01347-51-2022      Data e Regjistrimit : 17/06/2022  
Numri i Vendimit: 51-2022-3391              Data e Vendimit : 13/09/2022

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Andri Ymeri

SEKRETARE: Mirsada Kastrati

Sot më datë 13/09/2022mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile që i përket :  
Kërkues "Becker Albania" SHA

**Objekti:**Leshimin e urdherit te ekzekutimit. Venien e detyrimit ne ekzekutim te detyrueshem se bashku me kamatvonesat .

**Baza Ligjore:**neni 510, 511 K.Pr.Civile

VEREN :

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e përfaqësuar nga:

**ANDRI YMERI - GJYQTAR**

Me cilësimin e gjyqtarit të vetëm në dhomë këshillimi sot, me datë 13/09/2022 mora në shqyrtim çështjen civile që i përket:

**KËRKUES:**  
**OBJEKTI:**  
**BAZA LIGJORE:**

Shoqëria "Becker Albania" sh.a, me NUIS L02207017E, me përfaqësues ligjor z. Kujtim Prifti dhe me adresë: Bushat-Shkëzë, SH1, 4021, vend i depozitimit të mbetjeve, Vau i Dejës, zona kadastrale 3389, me nr.pasurie 425/4, Shkodër.

Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për titujt ekzekutivë:

1. Fatura Tatimore Nr.15, Nr. Serie 46934515, datë 31.08.2017 dhe me vlerë 5.942.505,63 lekë.
2. Fatura Tatimore Nr.26, Nr. Serie 46934526, datë 30.09.2017 dhe me vlerë 4.608.296,60 lekë.
3. Fatura Tatimore Nr.33, Nr. Serie 46934533, datë 30.11.2017 dhe me vlerë 3.672.406,32 lekë.
4. Fatura Tatimore Nr.35, Nr. Serie 46934535, datë 31.12.2017 dhe me vlerë 3.842.148,80 lekë.
5. Fatura Tatimore Nr.37, Nr. Serie 46934537, datë 31.01.2018 dhe me vlerë 3.553.888,61 lekë.
6. Fatura Tatimore Nr.40, Nr. Serie 46934540, datë 28.02.2018 dhe me vlerë 3.163.033,43 lekë.
7. Fatura Tatimore Nr.42, Nr. Serie 46934542, datë 31.03.2018 dhe me vlerë 3.722.938,06 lekë.
8. Fatura Tatimore Nr.44, Nr. Serie 46934544, datë 30.04.2018 dhe me vlerë 4.037.114,38 lekë.
9. Fatura Tatimore Nr.46, Nr. Serie 46934546, datë 31.05.2018 dhe me vlerë 4.417.818,73 lekë.
10. Fatura Tatimore Nr.48, Nr. Serie 46934548, datë 30.06.2018 dhe me vlerë 4.619.795,09 lekë.
11. Fatura Tatimore Nr.3, Nr. Serie 49334603, datë 31.07.2018 dhe me vlerë 5.346.362,05 lekë.
12. Fatura Tatimore Nr.4, Nr. Serie 49334604, datë 31.08.2018 dhe me vlerë 5.516.707,73 lekë.

Të lëshuara nga kërkuesi "Becker Albania" sh.a për debitorin "Ndërkomunale Bushat" sh.a me NUIS K87108002A, me përfaqësues ligjor z. Agron Çeka dhe me adresë: Bushat-Shkëzë, Sh1, 4021, Vend depozitim i mbetjeve, Vau i Dejës, zona kadastrale 3389, me nr.pasurie 425/30, Shkodër.

Vënien e detyrimit në ekzekutim të detyrueshëm së bashku me kamatëvonesat sipas përcaktimeve të nenit 5 të ligjit Nr.48/2014, datë 24.04.2014.

Nenet 510/e, 511/d të K.Pr.Civile, si dhe nenet 4, 5, 6 11, 12, 16 të Ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" si dhe ligji nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (I ndryshuar).

Pasi mora në shqyrtim pa praninë e palëve kërkesën objekt gjykimi, duke iu referuar përmbajtjes së saj dhe provave shkresore bashkangjitur

**V E R E J - s e ;**

Pala kërkuese Shoqëria "Becker Albania" sh.a i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë me anë të së cilës ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për fatura tatimore të shitjes sipas objektit.

Shqyrtimi i kësaj kerkese bëhet pa praninë e palëve, duke iu referuar për këtë ndryshimeve dhe shtesave në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr.114/2016, publikuar në Fletoren Zyrtare me nr.219, dt.15.11.2016, të cilat kanë hyrë në fuqi më dt.01.12.2016 (I

jar).

Mbi bazën e këtyre ndryshimeve (në fuqi në momentin e marrjes në shqyrtim të kësaj kërkesë, sipas parimit se norma procedurale civile ndjek një rrugë tjetër nga ajo materiale dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor zbatohet norma procedurale në fuqi, për aq sa nuk ka një parashikim të ndryshëm në dispozitat kalimtare) lëshimi i urdherit të ekzekutimit bëhet vetëm mbi bazën e dokumenteve të depozituara nga ana e kërkuësit në kryesekretari se bashku me kërkesën objekt shqyrtimi (dmth, me rregullimin e ri, shqyrtimi i kërkesës dhe disponimi mbi bazueshmerise ne ligj e ne prova te saj, behet pa u planifikuar dhe pa u zhvilluar nje seance gjyqesore, per pasoje, pa u mbajtur nje procesverbal nga sekretari i seances gjyqesore, ç'ka perben rregullimin e pergjithshem sipas neneve 77, 118, 118/1 te Kodit te Procedures Civile, dispozita keto te ndryshuara me ligjin nr.122/2013 ).

Në lidhje me kërkesën për lëshim urdhri ekzekutimi Gjykata konstaton se pala kërkuese është një shoqëri e te drejtes tregtare shqiptare e rregjistruar me date 29.09.2010, me objekt te aktivitetit te saj: *Menaxhimi i mbetjeve te ngurta. Eksportimi/importimi i mbetjeve te ngurta si makinerive dhe pajisjeve te nevojshme per kryerjen e veprimtarise se menaxhimit dhe te trajtimit te mbetjeve te ngurta. Veprimtari te konsultimit ne fushen e menaxhimit te mbetjeve te ngurta. Hedhja e mbetjeve urbane te qyteteve ose komunave si dhe te shoqerive industriale dhe tregtare dhe mbetjeve te tjera. Ngritja dhe funksionimi i venddepozitimeve dhe pajisjeve te hedhjes dhe grumbullimit. Ngritja dhe funksionimi i pajisjeve te riciklimit si dhe tregtimi i produkteve te ricikluara. Pastrim i rrugeve. Pastrimi i kanaleve dhe kanaleve te rinovimit. Sherbime te depozitimit. Shkaterrimi dhe rinovimi i venddepozitimeve industriale. Trajtimi dhe perpunimi i mbetjeve te rrozikshme. Cmontimi dhe pastrimi i venddepozitimeve, cisternave. Shkaterrimi i dokumentave. Tregtim materiale te para, produkte te gatshme dhe gjysem te gatshme.*

Nga Shoqëria "Becker Albania" sh.a, në cilësinë e shitësit janë lëshuar disa fatura tatimore të shtjete kundrejt blerësit Ndërkomunale Bushat sh.a.

Faturat tatimore te cituara me lart përmbajnë të plotësuar të gjitha kërkesat e ligjit në lidhje me të gjithë elementet e tyre. Ne referim te ligjit 48/2014, qellimi dhe fusha e zbatimit te te cilit rregullohen ne nenet 1 dhe 2 te tij citojme: "Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregulave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamateve ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme".

Ky ligj zbatohet për të gjitha pagesat e kryera si kundërpaguesë për veprimet juridike tregtare. Nuk i nënshtrohen rregulimeve të këtij ligji detyrimet apo pagesat:

- a) që janë objekt i procedurës së falimentimit të çelur kundër debitorit, përfshirë edhe procedurën me objekt ristrukturimin e borxhit;
- b) që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët;
- c) që lidhen me interesin apo pagesat e tjera të kryera për titujt;
- ç) që lidhen me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, përfshirë edhe pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit'.

Në nenin 16 të këtij ligji përcaktohet: 1. *Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:*

- a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit;
- b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile".

Ne rastin ne gjykim jemi perpara detyrimeve monetare te percaktuara qoftë në pikën "a", qoftë në pikën "b" të nenit 16 të ligjit nr.48/2014. Lëvrimi i mallit, si sende të luajtëshme, për të cilat ligji nuk kërkon në tjetërsimin e tyre formë kontraktore me shkrim si element vlefshmërie, del nga pjesëmarrja në këtë faturë dhe e transportuesit (data e furnizimit dhe nënshkrimi i furnizuesit, që në rastin konkret është vetë pala shitëse që e ka kryer furnizimin) dhe moskundershtimi i debitorit nga vetë nënshkrimi i faturës tatimore. Detyrimi në rastin në gjykim, ka lindur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Sipas palës kërkuese detyrimi monetar i përcaktuar në faturat e mësipërme tatimore nuk është përmbushur nga subjekti tregtar blerësi Ndërkomunale Bushat sh.a dhe ne këto kushte kërkuesi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar lëshimin e urdherit të ekzekutimit të faturave tatimore të shitjes, duke i konsideruar ata si titull ekzekutiv.

Në ligjin 48/2014 përcaktohet se: "Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor, pavarësisht vlerës ....."

Neni 511/e i K.Pr.Civile, parashikon se: "Ekzekutimi i detyrueshem mund te behet vetem ne baze te nje titulli ekzekutiv. Jane tituj ekzekutiv: e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre".

Gjithashtu ne nenin 511/ç te K.Pr.Civile sanksionohet qe: "Titulli ekzekutiv vihet ne ekzekutim me kerkesen e kreditorit. Per kete qellim leshohet urdheri i ekzekutimit i cili jepet:

- ç) për rastet e parashikuara nga shkronjat "d", "dh" dhe "e", lëshohet nga gjykata e vendit ku detyrimet që përmban titull ekzekutiv do të përmbushen, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit".

Sa më sipër vlerësoj se faturat tatimore të shitjes janë tituj ekzekutiv dhe se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi shoqëria "Becker Albania" sh.a për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të titullit ekzekutiv fatura tatimore te shitjes është e drejtë pasi bazohet në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

zuar në nenet 3, 4, 14, 18, 19, 511 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar,

**Për këto arsye**

**Baza Ligjore:**

**VENDOSI:**

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes
  - Fatura Tatimore Nr.15, Nr. Serie 46934515, datë 31.08.2017 dhe me vlerë 5.942.505,63 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.26, Nr. Serie 46934526, datë 30.09.2017 dhe me vlerë 4.608.296,60 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.33, Nr. Serie 46934533, datë 30.11.2017 dhe me vlerë 3.672.406,32 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.35, Nr. Serie 46934535, datë 31.12.2017 dhe me vlerë 3.842.148,80 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.37, Nr. Serie 46934537, datë 31.01.2018 dhe me vlerë 3.553.888,61 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.40, Nr. Serie 46934540, datë 28.02.2018 dhe me vlerë 3.163.033,43 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.42, Nr. Serie 46934542, datë 31.03.2018 dhe me vlerë 3.722.938,06 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.44, Nr. Serie 46934544, datë 30.04.2018 dhe me vlerë 4.037.114,38 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.46, Nr. Serie 46934546, datë 31.05.2018 dhe me vlerë 4.417.818,73 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.48, Nr. Serie 46934548, datë 30.06.2018 dhe me vlerë 4.619.795,09 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.3, Nr. Serie 49334603, datë 31.07.2018 dhe me vlerë 5.346.362,05 lekë.
  - Fatura Tatimore Nr.4, Nr. Serie 49334604, datë 31.08.2018 dhe me vlerë 5.516.707,73 lekë, duke përfshirë edhe kamatë vonesat deri në datën e ekzekutimit sipas nenit 5 të ligjit me nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".
3. Kunder këtij vendimi nuk lejohet ankim.  
U shpall në Shkodër, sot me datë 13.09.2022

Gjyqtar

Andri Ymeri

**SHPENZIMET GJYQESORE**

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

**GJYQTAR:**

**Andri Ymeri**

BKT - DEGA BUSHAT  
Qender Bushat  
SHKODER ALBANIA

2

STATEMENT OF ACCOUNT

513418634  
NDERKOMUNALE BUSHAT  
IBAN: AL8620551632418634CLPBCLALLT  
BIC/Swift code: NCBAALTX

513418634CLPBCLALLT3 ALL  
NDERKOMUNALE BUSHAT SHA

BUSHAT  
SHKODER

DATE OF STATEMENT 08-NOV-18  
FROM(NGA DATA): 01-OCT-18 TO(NE DATEN): 08-NOV-18

AccountNo:513418634CLPBCLALLT3 PAGE NO(FAQE): 1

Data DATE	Pershkrimi DESCRIPTION	Referenca REFERENCE	Date Valuta VALUE DATE	Debt DEBIT	Kredi CREDIT	Balanca BALANCE
01-OCT-18	OPENING BALANCE:				11,740,267.54	
BOOKING DATE: 03-OCT-18						
03-OCT-18	Salary Payment Batch 513p6S5182760002 NDERKOMUNALE BUSHAT SHA - NDERKOMUNALE BUSHAT SHA KALIM PAGE SHTATOR 2018	513p6S5182760002	03-OCT-18	64,313.00		11,675,954.54
BOOKING DATE: 04-OCT-18						
04-OCT-18	ACCOUNT TO ACCOUNT TRANSFER V.A.L.E RECYCLING SHPK SA KALON NE FAVOR TE NDERKOMUNALE BUSHAT SHA PER LIKUJDIM FAT.NR.821 DT.31.08.2018	510TAAT182770002	04-OCT-18		233,383.00	11,909,337.54
04-OCT-18	COMMISSION	513AIPS182770001	04-OCT-18	1,200.00		11,908,137.54
04-OCT-18	TRANSFER Ft - Event Desc INIT Ft - User Refno 513AIPS182770001 Ft - By Order Of /AL8620551632418634CLPBCLALLT Ft - Ben /ALS9901511500044213010000018-BECKER ALBANIA SHA Ft - Payment D1 LIKUIDIM FATURE MUAJI GUSHT 2018 Ft - Charges Desc1 AIPS_CUST Ft - Charge Amt1 1,200.00 ALL	513AIPS182770001	04-OCT-18	5,516,708.00		6,391,429.54
BOOKING DATE: 05-OCT-18						
05-OCT-18	ACCOUNT TO ACCOUNT TRANSFER NIKO SHOES SHPK LIK FAT ME NR 798 DT 31.07.2018 NE FAVOR TE NDERKOMUNALE BUSHAT SHA	513TAAT182780005	05-OCT-18		12,302.00	6,403,731.54
BOOKING DATE: 08-OCT-18						
08-OCT-18	TRANSFER Ft - Event Desc INIT Ft - User Refno 400FNIC182810300 Ft - By Order Of ECO RICIKLIM SHPK-/AL30202120210000000011229544 Ft - Ben /AL8620551632418634CLPBCLALLT-NDERKOMUNALE BUSHAT SHA Ft - Payment D1 LIK FAT NR 828 DT 300918 Ft - Payment D2 . Ft - Payment D3 . Ft - Payment D4 500601685 Ft - Charges Desc1 FNIC-TJERE Ft - Charge Amt1 0.00 ALL Ft - Charges Desc2 FNIC_IBAN Ft - Charges Amt2 0.00 ALL	400FNIC182810300	08-OCT-18		33,119.00	6,436,850.54
08-OCT-18	TRANSFER Ft - Event Desc INIT Ft - User Refno 400FNIC182810302 Ft - By Order Of ECO RICIKLIM SHPK-/AL30202120210000000011229544 Ft - Ben /AL8620551632418634CLPBCLALLT-NDERKOMUNALE BUSHAT SHA Ft - Payment D1 LIK FAT NR 824 DT 010918 Ft - Payment D2 . Ft - Payment D3 . Ft - Payment D4 500602147 Ft - Charges Desc1 FNIC-TJERE Ft - Charge Amt1 0.00 ALL Ft - Charges Desc2 FNIC_IBAN Ft - Charges Amt2 0.00 ALL	400FNIC182810302	08-OCT-18		29,970.00	6,466,820.54
08-OCT-18	TRANSFER Ft - Event Desc INIT Ft - User Refno 400FNIC182811082	400FNIC182811082	08-OCT-18		44,882.00	6,511,702.54



3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vau Dejës, me 21.03.2023

Nr. ~~2033~~ / 11 prot

Nr. \_\_\_\_\_ prot

### MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

Sot, më datë 21.03.2023, në Vau Dejës, lidhet kjo Marrëveshje për Subvencionim midis palëve me të dhëna si më poshtë:

- **Bashkia Vau Dejës**, me adresë: Sheshi "Rr. Qafa e Gurit", përfaqësuar nga z. Mark Babani, Kryetar, (në vijim referuar si, "pala 1")

dhe


- **"Ndërkomunale Bushat" Sh.a.**, shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në adresën: Bushat, Vau Dejës", regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar, te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): K87108002A, përfaqësuar nga administratori Z. Agron Çeka, (ne vijim, "pala 2")

Me poshte referuar bashkarisht si "Palet" dhe veç e veç perkatesisht si "pala" dhe të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë lidhin këtë Marrëveshje për subvencionim.

Marrëveshja hartohet në bazë të Ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar; Në Vendimin e Keshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 84 datë 23.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2023-2025, numrin e punonjesve për Bashkinë Vau Dejës " Të miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me shkrese nr. 24/1 datë 12.01.2023

### MEQENËSE

- A. Shoqëria "Ndërkomunale Bushat" sha, ka si aksioner të vetëm 100%. (njëqind përqind) Bashkinë Vau Dejës



- B. Përmbaruesi Gjyqësor Emirjeta Zisi, me shkresën nr. 290 prot, datë 03.10.2022, ka njoftuar shoqërinë "Ndërkomunale Bushat" sha, mbi vendimin e gjykatës nr. 507 (3391) datë 13.09.2022, me anë të së cilës kjo e fundit rezulton debitore në shumën 68, 519, 913.04 (gjashtëdhjetëtetëmilionë e pesëqindëntëmbëdhjetë e nëntëqindetrembëdhjetë pikë zerokatër) lekë.
- C. Duke qënë së Shoqëria "Ndërkomunale Bushat" sha dhe përmbaruesi kanë dakordësuar parimisht për të realizuar me këste shlyerjen e detyrimeve, me qëllim që mos të vendoset masa e sakuestros mbi shoqërinë.
- D. MeVendimin e Keshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 84 datë 23.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2023-2025, numrin e punonjesve për Bashkinë Vau Dejës " Të miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me shkresë nr. 24/1 datë 12.01.2023 është vendosur nga këshilli bashkiak se shuma 10 000 000 lekë do të kalojë në favor të shoqërisë për të plotësuar nevojat e saj për zgjidhjen e situates financiare të krijuar rishtazi"

**SA ME SIPER**, Palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje me përmbajtjen, kushtet dhe afatet si vijon:

## NENI 1 OBJEKTI

1.1. Objekti i kësaj Marrëveshje për Subvencionim është dhënia e subvencionit, nga pala 1 tek pala 2, në shumën prej 10 000 000 lekë (*dhjetëmilionë lekë*) - të gjitha njëheresh, me qëllim shlyerjen e detyrimeve që kjo shoqëri ka ndaj debitorit, në zbatim të vendimit të gjykatës nr. 507 (3391) datë 13.09.2022.

## NENI 2 QËLLIMI DHE GJENDJA E SUBVENCIONIT

- 2.1. Ky subvencion jepet nga Pala 1 tek Pala 2 me qëllim të përcaktuar, për shlyerjen e detyrimeve që pala 2 ka ndaj debitorit, në zbatim të vendimit të gjykatës nr. 507 (3391) datë 13.09.2022.
- 2.2. Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Palët deklarojnë se nuk është bërë kalimi i shumës. Disbursimi i saj do të bëhet sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 3 më poshtë.

## NENI 3 DISBURSIMI

3.1. Pagesa do të disbursohet, me anë të transfertës bankare, drejtpërdrejtë në llogarinë bankare me numer 513418634 dhe IBAN AL8620551632418634CLPBCLALIT



3.2. Pagesa do të disbursohet brenda 5 ditësh punë nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

**NENI 4  
KOHEZGJATJA E MARRËVESHJES**

4.1. Kjo Marrëveshje lidhet deri në përiudhën e arritjes së qëllimit të saj, i cili është disbursimi i shumës sipas nenit 1 të saj, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj.

**NENI 5  
LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

8.1. Të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar dhe parashikuar shprehimisht këtu do të rregullohen nga legjislacioni i zbatueshëm i Republikës së Shqipërisë, përfshirë, por jo vetëm, dispozitat e Kodit Civil.


8.2. Në çdo rast mosmarrëveshjes në lidhje me këtë Marrëveshje për Subvencionim, ato do të zgjidhen në mirëkuptim midis Palëve.


**NENI 6  
TË TJERA**

9.1. Marrëveshje për Subvencionim mund të ndryshohet vetëm në marrëveshje me shkrim midis Palëve.

9.2. Kjo Marrëveshje përpilohet në 4 kopje në gjuhën shqipe.


**Për Bashkinë Vau Dejës**

  
Mark Babani



**Për Ndërkomunale Bushat SHA**

Agron Çeka



4

OMA 4/1 Prot  
dt. 13.01.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 24/1 prot.

Shkodër, më 12.01.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr. 84, datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", neni 14, shkronja "f", neni 15, të ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.1, shkronja "a", pika 1.3, shkronja "c", neni 18, neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 54, shkronja "dh" dhe "k", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "e", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 4, neni 5, neni 6, shkronja b, ç dhe d, neni 7, pika 1, neni 39, neni 40, neni 41, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë" i ndryshuar, neni 6, neni 17, neni 32, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV", të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025", të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 08.07.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025", të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau i Dejës nr. 1 prot., datë 04.01.2023 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 23.12.2022", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2023-2025, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës & VKB Nr. 86, datë 23.12.2022 "Për miratimin e projekteve prioritare të investimeve të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023", me këto elementa:

1. Buxheti i Bashkisë Vau Dejës, ka burime buxhetore për vitin 2023 në vlerën totale prej 913.987 mijë lekë, nga ku transfera e pakushtëzuar është 267.764 mijë lekë, transfera e kushtëzuar është 358.161 mijë lekë, transfera e pakushtëzuar sektoriale është 118.044 mijë lekë (në të cilën përfshihen, fondet për konviktet e arsimit parauniversitar 9.077 mijë lekë, arsimit parashkollor, e detajuar personeli mësimor 42.501 mijë lekë, stafi mbështetës 1.047 mije lekë, arsimit parauniversitar 2.559 mije lekë, mbrojtja nga zjarri 13.972 mijë lekë, mbrojtja sociale 19.958 mijë lekë, administrimi i pyjeve 7.184 mijë lekë, rugët

I miratuar me 20 vota pro

Adresa: "Rruga 28 Nëntori" Shkodër, Telefon/Faks +355 2224 2705, e-mail: Prefekti.Shkodër@mb.gov.al

6.306 mijë lekë, ujitja dhe kullimi 13.240 mijë lekë, menaxhimin e mbetjeve urbane 2.200 mijë lekë.

2. Plani i të ardhurave për vitin 2023 është në vlerën 170.018 mijë lekë,
3. Fondi i të ardhurave të trashëguara 879.225 mijë lekë,
4. Fondi rezervë dhe kontigjencë për vitin 2023 është planifikuar në vlerën prej 500 mijë lekë ose 0,9% e buxhetit,
5. Investimet e planifikuara për vitin 2023 janë në vlerën prej 94.414 mijë lekë,
6. Numri i punonjësve për vitin 2023 është 388 punonjës,
7. Fondi për mbrojtjen civile (burimet e vetë bashkisë) dhe mbrojtjen nga zjarri për vitin 2023 është planifikuar në vlerën prej 41.204 mijë lekë ose 4,94% e buxhetit të vitit 2023.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**Majlinda ANGONI**



5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KRYETARI

Nr. 2097/Prot.  
11

Vau Dejes, më 23.03.2023

URDHËR

Nr. 126/ Datë 23.03.2023  
11

PËR


**“ LIKUJDIMIN E VLERËS SIPAS MARRËVESHJES PËR SUBVENCIONIM ”**

Bazuar në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015“Për veteqeverisjen vendore“ i ndryshuar; Ligji Nr. 115/2014 date 31.07.2014 “ Për ndarjen administrativo territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin Nr.9936 datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”; Ligjin nr.68/2017“Per financat e veteqeverisjes vendore”; Ligji nr 84/2022 “ Për buxhetin e vitit 2023”; VKB nr 84 dt 23.12.2022 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, Shprehje ligjshmërie nr 24/1 prot dt 12.01.2023; Marrëveshje për subvencionim;

**URDHËROJ:**

- 1.Likujdimin e vlerës prej 10.000.000 ( dhjetë milion) lek , sipas marrëveshjes për subvencionim, bashkëngjitur këtij urdhëri.
  - 2.Ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe Financës) për zbatimin e këtij urdhëri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
Mark Babani



Digitally signed by Renado Doda  
Date: 03.04.2023 11:27:14 CEST  
Reason: Regjistrues  
Location: Shqipëri

Digitally signed by Albert Ndoci  
Date: 03.04.2023 12:17:45 CEST  
Reason: Nëpunës zbatues  
Location: Shqipëri

Digitally signed by Mark Babani  
Date: 03.04.2023 12:32:19 CEST  
Reason: Nëpunës autorizues  
Location: Shqipëri

Digitally signed by Alfred Pepa  
Date: 04.04.2023 16:20:33 CEST  
Reason: Nëpunës thesari  
Location: Shqipëri

<b>Institucioni</b>	Bashkia Vau Dejes
<b>NIPT - i</b>	K 567050070
<b>Kod Institucioni</b>	2157001
<b>Entiteti i Qeverisjes</b>	157
<b>Distrikti (TDO)</b>	3333
<b>Nr. i Kuponit</b>	

### URDHER - SHPENZIMI

NR. 161 DATE 03.04.2023

Nr. i Punonjseve

Nr.	Struktura e llogarive						SHUMA ne Leke	Objekti i shpenzimit
	Gr.	Kap.	Kod progr m	Llogaria Ekonomike	Nen Llogaria	Kod Projekti		
1	00	05	05100	603	6030099	9999999	10,000,000.00	Subvencione te tjera te ngjashme
								Subvencion per vendimet gjyqesore per Nderkomunale Sha
TOTALI ME SHIFRA							10,000,000.00	X
TOTALI ME FJALE							Dhjetë milion	

IBAN AL86 2055 1632 4186 34CL PBCL ALLT

Te dhena per kreditorin perfitues :	
Emri i perfituesit	NDERKOMUNALE BUSHAT
NIPT - i	K87108002A
Nr.llog.bank	AL86 2055 1632 4186 34CL PBCL ALLT
Emri Bankes	Banka Kombetare Tregtare
Adresa e Bankes	
Shkoder	

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit :		
Emertimi	Nr. Dokumenti	Date Dok
Çek		
Xhirim		
blerjes		
Te tjera	1.Urdher titullari nr 126/1	23.03.2023
(Emertime, numer date)	2.Marveshje per subvencionim 2033/1	21.03.2023
	3.VKB nr 84	23.12.2022
	4.Shprehje Ligjshmerie nr 24/1	12.01.2023

pagese e menjehershme

Shenim: Qelizat per "Nr. i kuponit" plotesohet nga nepunesi i Thesarit/Institucioni buxhetor